

# RAPORT

mbi financimin e OJQ-ve  
nga **fondet e BE-së**  
për v. **2024**

**BOTUES:**

**Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare  
(CRNVO)**

**rr. Sima Barovića 24, Podgoricë**

**Tel/fax: 020/219 120, 219 121, 219 122, 219 123**

**E-mail: [crnvo@crnvo.me](mailto:crnvo@crnvo.me) [www.crnvo.me](http://www.crnvo.me)**

**Titulli i publikimit:**

**HULUMTIM PËR PJESËMARRJEN E OJQ-ve  
NË HARTIMIN E POLITIKAVE PUBLIKE  
NË v. 2024**

**PËR BOTUESIN:**

**Zorana Marković**

**AUTORËT:**

**Filip Vicković**

**Nazif Veliq**

**Zdravko Janjušević**

**Marina Vuksanović**

**Milan Medenica**

**Kenan Keçević**

**Zorana Marković**

**BASHKËPUNTORËT NË HULUMTIM:**

**Milosh Marković**

**Aleksa Miniq**

**Hazreta Cuca**

**PËRGATITJA dhe DIZAJNI**

**New Page D.O.O.**

**Podgoricë, korrik 2025.**

Raporti u përgatit në kuadër të projektit “Rrjeti i qendrave burmiore të Malit të Zi”. Pikpamjet dhe përfundimet e paraqitura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal-Investues dhe bashkëpunimit me organizatat joqeveritare.

Bashkimi Evropian, për më shumë se dy dekada, përfaqëson një partner kyç të Malit të Zi në procesin e integritimeve evropiane, ku organizatat joqeveritare luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces. Që nga fillimi i procesit të integritimit evropian të Malit të Zi, Bashkimi Evropian e ka njohur shoqërinë civile si një partner të rëndësishëm në proceset reformuese dhe demokratizuese, gjë që pasqyrohet në qasjen e hershme në instrumentet financiare të dedikuara për organizatat joqeveritare.

Përmes fondeve dhe programeve të ndryshme të BE-së, OJQ-të në Mal të Zi fitojnë mundësinë të realizojnë projekte që kontribuojnë në demokratizimin e shoqërisë, forcimin e sundimit të ligjit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përmirësimin e arsimit, bashkëpunimin kulturor, inovacionet dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Prandaj, fondet e BE-së nuk janë vetëm instrumente financiare, por edhe një mekanizëm për përfshirjen e sektorit civil në krijimin e politikave, forcimin e kapaciteteve të organizatave dhe lidhjen me partnerët nga rajoni e më gjerë në Evropë. Në periudhën fillestare, mbështetja për sektorin e OJQ-ve është siguruar kryesisht përmes Instrumentit të Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA), i prezantuar në vitin 2007, e më pas përmes pasardhësve të tij, IPA II (2014–2020) dhe IPA III aktual (2021–2027), me linja të veçanta për zhvillimin e shoqërisë civile, forcimin e demokracisë, të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe lirisë së mediave.

Paralelisht me këto instrumente, BE-ja gjatë viteve të fundit ka zgjeruar ndjeshëm mundësitë e financimit të OJQ-ve përmes programeve të centralizuara dhe tematike që janë të qasshme për organizatat nga Mali i Zi. Ndërmjet tyre vlerësohet si veçanërisht i rëndësishëm Erasmus+ – Programi i Bashkimit Evropian për arsimin, rininë dhe sportin. Në periudhën më të re, nga viti 2021, OJQ-të kanë fituar qasje edhe në programin CERV – Qytetarët, barazia, të drejtat dhe vlerat, i cili mbështet direkt organizatat e shoqërisë civile në fushën e të drejtave të njeriut, mosdiskriminimit dhe pjesëmarrjes demokratike, si dhe në një spektër të gjerë të programeve Interreg dhe programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, përmes të cilëve financohen projekte të zhvillimit rajonal, mbrojtjes së mjedisit jetësor, trashëgimisë kulturore dhe inkluzionit social. Ky zhvillim i instrumenteve të financimit tregon se BE-ja në Mal të Zi jo vetëm që e njeh rëndësinë e shoqërisë civile, por edhe e forcon atë në mënyrë sistematike përmes një mbështetjeje financiare afatgjatë dhe gjithnjë e më të larmishme, duke i parë OJQ-të si akterë kyç në procesin e demokratizimit dhe integritimit evropian.

Ky raport synon të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe sistematike të mbështetjes financiare që organizatat joqeveritare (OJQ) realizojnë nga fondet e Bashkimit Evropian (BE). Publikimi është konceptuar në atë mënyrë që të paraqesë në formë të qartë dhe të kapshme vëllimin, strukturën dhe prioritetet tematike të mbështetjes së BE-së për shoqërinë civile, me një theks të veçantë në programet dhe instrumentet që janë të disponueshme për organizatat në Mal të Zi dhe në rajonin më të gjerë të Ballkanit Perëndimor.

Me këtë rast, është e rëndësishme të theksohet se ekzistojnë disa kufizime metodologjike sa i përket disponueshmërisë së të dhënave për projektet që zbatohen nga OJQ-të nga Mali i Zi në kuadër të programeve evropiane. Një numër i konsiderueshëm i fondeve menaxhohet jashtë Malit të Zi, dhe vendimet për ndarjen e projekteve nuk janë gjithmonë të publikuara zyrtarisht ose u referohen ekskluzivisht aplikantëve kryesorë, pa një pasqyrim të detajuar të organizatave partnere. Rrjedhimisht, informacionet e paraqitura në këtë raport bazohen në burime publike të disponueshme dhe janë plotësuar përmes intervistave me OJQ-të e identifikuar nga Mali i Zi, të cilat gjatë vitit 2024 kanë përfituar mjete për realizimin e projekteve.

Në këtë mënyrë, raporti synon që, me gjithë kufizimet në transparencë dhe në disponueshmërinë e të dhënave, të ofrojë një pasqyrë të besueshme dhe përfaqësuese mbi vëllimin dhe natyrën e mbështetjes së BE-së për shoqërinë civile në Mal të Zi.

### Fondet IPA dhe financimi i OJQ-ve

Instrumenti i Ndhmës së Para-Anëtarësimit (IPA), që nga viti 2007, është kanali kryesor i mbështetjes financiare të BE-së për Malin e Zi. Në kuadër të IPA II (2014–2020), Malit të Zi i janë vënë në dispozicion 116 milionë euro, ndërsa në IPA III (2021–2027) janë vënë në dispozicion afërsisht 105 milionë euro grante (mjete të pakthyeshme) për reforma dhe projekte zhvillimore. Një pjesë e këtyre mjeteve është drejtpërdrejt e qasshme për organizatat joqeveritare përmes komponentëve të veçantë.

### Civil Society Facility (CSF) – programi nacional në kuadër të IPA III

Civil Society Facility (CSF) është një instrument i Bashkimit Evropian që nga viti 2008 përdoret për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile në vendet kandidate dhe kandidatët potencialë për anëtarësim në BE. Në kuadër të IPA III (2021–2027), CSF ka vazhduar si program nacional në çdo vend të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Malin e Zi. Programi përfaqëson një nga burimet më të rëndësishme të financimit për OJQ-të në Mal të Zi dhe synon:

- Forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile;
- Mbështetjen e organizatave që promovojnë vlerat demokratike, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe transparencën;
- Aftësimin e OJQ-ve për të marrë pjesë në krijimin dhe monitorimin e politikave publike;
- Kontributin në luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e qeverisjes së mirë.

Ky program u mundëson organizatave joqeveritare të zhvillojnë projekte që merren me edukimin, trajnimet dhe rrjetëzimin, si dhe me iniciativa që kontribuojnë në transparencë dhe luftën kundër korrupsionit. Është veçanërisht i rëndësishëm sepse u jep hapësirë OJQ-ve të përfshihen aktivisht në procesin e integriteteve evropiane dhe që përmes projekteve të tyre të ndikojnë në krijimin e politikave publike. Në praktikë, kjo do të thotë se shumë organizata malazeze kanë pasur mundësinë të bashkëpunojnë me partnerë nga rajoni dhe të shkëmbejnë përvoja në fusha si qeverisja e mirë dhe forcimi i institucioneve demokratike.

Thirrjet për CSF-në nacionale në Mal të Zi shpallen nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Mal të Zi. Delegacioni i BE-së udhëheq të gjithë procesin – nga shpallja e thirrjes, përmes vlerësimit të aplikimeve, e deri te nënshkrimi i kontratave me OJQ-të e përzgjedhura. Në vitin 2024, për OJQ-të në Mal të Zi përmes këtij programi ishin paraparë rreth 1,2 milionë euro.

### Programi Tematik për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë NDICI

Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (European Instrument for Democracy and Human Rights - EIDHR) përfaqëson një nga mekanizmat më të rëndësishëm financiarë të Bashkimit Evropian të dedikuar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai u themelua në vitin 2007 si program i pavarur, me qëllim që t'u ofrojë mbështetje organizatave të shoqërisë civile që merren me tema të ndjeshme, të cilat shpesh nuk janë të përfaqësuar mjaftueshëm në fondet e tjera. Gjatë më shumë se një dekade të ekzistencës së tij, EIDHR u ka mundësuar organizatave joqeveritare të realizojnë projekte në fushat e lirisë së mediave, barazisë gjinore, mbrojtjes së pakicave dhe grupeve të marginalizuara, si dhe monitorimit të pavarur të gjendjes së të drejtave të njeriut. Në kuadër të reformës së instrumenteve financiare të Bashkimit Evropian, të zbatuar për racionalizimin dhe bashkimin e programeve të ndryshme, EIDHR në vitin 2024 u integrua në kornizën më të gjerë Global Europe – NDICI (Neighbourhood, Development and International Cooperation Instrument) / Instrumenti për Fqinjësi, Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

<sup>1</sup> <https://rtnk.me/ekonomija/za-sedam-godina-evropska-komisija-crnoj-gori-dodijelila-priblizno-116-miliona-eura-bespovratne-pomoci-iz-ipa-fondova/>

Nga qershori i vitit 2024, EIDHR është riemëruar zyrtarisht në Programi Tematik për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë, duke u bërë kështu pjesë e programeve tematike të NDICI-t. Ky ndryshim nuk nënkuptoi humbjen e qëllimeve të tij themelore, por zgjerimin dhe forcimin e tyre institucional përmes lidhjes me dimensionet e tjera të politikës së jashtme të BE-së.

Në praktikë, EIDHR/NDICI vazhdon të ofrojë mbështetje financiare për projekte që merren me tema të ndjeshme, përfshirë mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI, promovimin e barazisë gjinore, forcimin e kapaciteteve të organizatave që merren me monitorimin e pavarur të të drejtave të njeriut, si dhe iniciativa që lidhen me lirinë e shprehjes dhe të mediave.

Gjatë vitit 2024, në Mal të Zi, përmes EIDHR/NDICI u shpall një thirrje nacionale nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Mal të Zi, me një buxhet të përgjithshëm prej rreth 1,05 milionë eurosh.

### Civil Society Facility (CSF) – Ballkani Perëndimor

Civil Society Facility (CSF) – Ballkani Perëndimor është një instrument i veçantë financiar i Bashkimit Evropian, i themeluar në vitin 2008 në kuadër të fondeve IPA, me qëllim të fuqizimit të organizatave të shoqërisë civile në rajon dhe rritjes së rolit të tyre në procesin e integriteteve evropiane. Ky fond rajonal përfshin të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor – Malin e Zi, Serbinë, Bosnjë-Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë, Kosovën dhe Turqinë – me mundësinë e bashkëpunimit me organizata nga shtetet anëtare të BE-së. Ai është i fokusuar në rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe iniciativat e përbashkëta ndërmjet OJQ-ve nga disa vende të Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i tij është të fuqizojë organizatat e shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi, të rrisë rolin e tyre në procesin e integritetit evropian dhe të nxisë bashkëpunimin rajonal.

Në kuadër të IPA III (2021–2027), CSF për Ballkanin Perëndimor zbatohet përmes programeve shumëvjeçare. Programi rajonal CSF implementohet përmes thirrjeve që udhëhiqen drejtpërdrejt nga Komisioni Evropian (Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit – DG NEAR). Këto thirrje u dedikohen projekteve që lidhin organizatat nga disa vende të Ballkanit Perëndimor, me theks në rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe iniciativat e përbashkëta.

Prioritetet tematike të CSF-së për Ballkanin Perëndimor përfshijnë:

- Demokracinë dhe sundimin e ligjit;
- Forcimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për të marrë pjesë në krijimin dhe monitorimin e politikave publike;
- Mbështetjen për rrjetet dhe platformat rajonale;
- Promovimin e dialogut midis shoqërisë civile dhe institucioneve;
- Lirinë e mediave dhe të shprehjes;
- Luftën kundër korrupsionit, pajtimin dhe shkëmbimin e përvojave.

Projektet e financuara përmes këtij instrumenti duhet të kenë një dimension rajonal, që do të thotë se duhet të përfshijnë partneritete midis organizatave nga të paktën dy vende të Ballkanit Perëndimor ose Turqisë.

Gjatë vitit 2024, u miratua programi EU Civil Society Facility and Media Programme 2024–2025 (Commission Implementing Decision C(2024) 2097 final), në vlerë të përgjithshme prej 132,4 milionë eurosh, me një buxhet të përcaktuar për vitin 2024 në vlerë prej pothuajse 39,5 milionë eurosh. Ky buxhet është i dedikuar për të gjithë rajonin, pa kuota nacionale të përcaktuara paraprakisht, kështu që mjetet i fitojnë ato organizata që konkurrojnë me sukses përmes projekteve rajonale. Thirrja ishte e hapur në vitin 2024, por kontratat e para me përfituesit u nënshkruan në vitin 2025, pas përfundimit të vlerësimit.

## Programi IPA për Bashkëpunim Ndërkufitar (IPA CBC / Cross-Border Cooperation)

Programet e bashkëpunimit ndërkufitar (CBC) në kuadër të Instrumentit të Ndhmës së Para-Anëtarësimit (IPA) janë themeluar në vitin 2007, kur Mali i Zi u bë përfitues i IPA I, dhe përfaqësojnë një nga instrumentet më të rëndësishme për lidhjen e Malit të Zi me shtetet fqinje. Gjatë periudhave IPA II (2014–2020) Lent dhe IPA III (2021–2027), programet CBC u zhvilluan në mekanizma të strukturuar financimi me qëllim të nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm në zonat kufitare përmes projekteve të përbashkëta me shtetet fqinje. Përmes këtij programi financohen projekte që nxisin turizmin e qëndrueshëm, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe zhvillimin e komuniteteve lokale. Një theks i veçantë u vihet iniciativave të përbashkëta që lidhin qytetet dhe komunat nga të dyja anët e kufirit, duke forcuar kështu kapacitetet e organizatave lokale dhe të sektorit joqeveritar.

Në të gjitha programet ndërkufitare, aplikantët duhet të jenë persona juridikë të regjistruar në zonën e programit dhe të kenë karakter jofitimprurës ose publik. Rrjedhimisht, të drejtë për të dorëzuar projekte kanë vetëqeverisjet lokale, institucionet publike, institucionet arsimore, agjencitë zhvillimore, qendrat kërkimore dhe organizatat joqeveritare. Pjesëmarrja e subjekteve ekonomike është e mundur vetëm në raste të veçanta, kur bëhet fjalë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme që marrin pjesë në projekte me interes publik, por me kufizime të rrepta dhe në partneritet me sektorin publik ose atë jofitimprurës.

Në vitin 2024, për programet e bashkëpunimit ndërkufitar (CBC) të IPA III ku merr pjesë Mali i Zi, janë programuar gjithsej rreth 16,2 milionë euro, të ndara përmes katër programeve dypalëshe (bilaterale): Mali i Zi–Bosnjë dhe Hercegovinë, Mali i Zi–Shqipëri, Mali i Zi–Kosovë dhe Mali i Zi–Serbi. Buxhetet e programeve CBC zakonisht ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet vendeve partnere, kështu që një pjesë e mjeteve u dedikohet aplikantëve malazezë, ndërsa pjesa tjetër partnerëve nga vendet fqinje. Gjithashtu, thirrjet shpallen bashkërisht dhe projektet duhet të përfshijnë partnerë nga të dyja vendet.

### CBC Mal i Zi - BeH

Ky program është aktiv që nga viti 2007, ndërsa në kuadër të IPA III (2021–2027) si fusha kryesore tematike ka të përcaktuara: Inovacionin dhe konkurrueshmërinë, ndryshimet klimatike, efikasitetin energjetik dhe forcimin e komuniteteve lokale. Thirrja e parë u shpall në maj të vitit 2024, me afat për aplikim në korrik të po atij viti. Gjatë vitit 2024 nuk pati nënshkrim të kontratave, pasi vlerësimi i projekteve ishte në proces e sipër, kështu që rezultatet priten në vitin 2025. Buxheti i paraparë për këtë thirrje ishte rreth 4,5 milionë euro.

### CBC Mal i Zi - Shqipëri

Programi është aktiv që nga viti 2007, dhe në kuadër të IPA III (2021–2027) fokusohet në turizmin e qëndrueshëm, bashkëpunimin kulturor dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Thirrja e parë për dorëzimin e propozim-projekteve në kuadër të këtij programi u publikua në mars të vitit 2024, ndërsa buxheti i paraparë për këtë thirrje kapte vlerën prej rreth 4,2 milionë eurosh. Gjatë vitit 2024 nuk erdhi deri te nënshkrimi i kontratave, pasi procesi i vlerësimit zgjati deri në fund të vitit, prandaj kontratat priten në gjysmën e parë të vitit 2025. Fushat që mund të mbështeteshin përmes kësaj thirrjeje përfshinin punësimin dhe inkluzionin social, mbrojtjen e mjedisit jetësor, turizmin e qëndrueshëm dhe zhvillimin ekonomik lokal.

<sup>3</sup> 3b8aaa61-c760-49de-b20e-270955cf9d92\_en

<sup>4</sup> <https://cbc.bih-mne.org/javni poziv/>

<sup>5</sup> IPA Cross-Border Cooperation Programme Montenegro-Albania 2021-2027

### CBC Mal i Zi - Kosovë

Programi është themeluar në vitin 2007, ndërsa në kuadër të IPA III (2021–2027) fokusohet në zhvillimin e qëndrueshëm, turizmin, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe inkluzionin social. Thirrja u publikua në prill të vitit 2024 dhe u mbyll në qershor të po atij viti. Ashtu si me programet e tjera CBC, kontratat nuk u nënshkruan gjatë vitit 2024, por priten pas përfundimit të vlerësimit në vitin 2025. Fushat tematike që u mbështetën përfshinin rininë dhe arsimin, bashkëpunimin kulturor, zhvillimin ekonomik lokal dhe mbrojtjen e burimeve natyrore, me një theks të veçantë në projektet që lidhin komunitetet nga të dyja anët e kufirit. Buxheti i paraparë për këtë thirrje ishte rreth 3,9 milionë euro.

### CBC Mal i Zi - Serbi

Programi i bashkëpunimit ndërkufitar midis Serbisë dhe Malit të Zi është themeluar në vitin 2007, ndërsa në kuadër të IPA III (2021–2027) programi është i orientuar drejt disa fushave kryesore tematike. Ai mbështet punësimin dhe inkluzionin social, veçanërisht të të rinjve dhe grupeve të cenuara, si dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe përgjigjen ndaj ndryshimeve klimatike. Përveç kësaj, një fokus i rëndësishëm i është kushtuar zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, ndërsa fusha e katërt ka të bëjë me inovacionin dhe konkurrueshmërinë, përfshirë mbështetjen për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe digjitalizimin. Thirrja u publikua në dhjetor të vitit 2023 me një alokim prej 3,6 milionë eurosh.

### Interreg

Programet Interreg, si pjesë e politikës së kohezionit të Bashkimit Evropian, kanë për qëllim të nxisin bashkëpunimin territorial midis shteteve anëtare dhe vendeve kandidate, përfshirë Malin e Zi. Esenca e tyre qëndron në krijimin e iniciativave të përbashkëta zhvillimore që kalojnë kufijtë kombëtarë dhe kontribuojnë në zhvillimin e integruar të rajoneve.

Programet Interreg në të cilat Mali i Zi ka qasje përfshijnë një spektër të gjerë të fushave tematike – nga inovacioni dhe kërkimi, përmes turizmit dhe bashkëpunimit kulturor, e deri te mbrojtja e mjedisit jetësor dhe forcimi institucional.

Organizatat joqeveritare nga Mali i Zi janë të përfshira aktivisht në realizimin e projekteve në kuadër të Interreg IPA CBC Kroaci–BiH–Mali i Zi, Interreg Europe, Interreg Danube Transnational Programme, Interreg Adria dhe Interreg Balkan-Mediterranean. Roli i tyre është i shumanshëm: nga zbatimi i aktiviteteve konkrete në nivel lokal, përmes krijimit të politikave publike, e deri te shkëmbimi i njohurive dhe përvojave me partnerët nga hapësira më e gjerë evropiane. Kjo konfirmon se programet Interreg përfaqësojnë jo vetëm një instrument financiar, por edhe një platformë strategjike për forcimin e kapaciteteve të sektorit civil në Mal të Zi dhe përfshirjen e tij aktive në proceset e integritimit evropian.

### Interreg IPA CBC Kroaci–BiH–Mali i Zi

Programi Interreg IPA CBC Kroaci–BiH–Mali i Zi është një program i bashkëpunimit ndërkufitar që zbatohet në kuadër të instrumentit financiar IPA. Programi ekziston që nga viti 2014, kur u hap cikli i parë në kuadër të periudhës financiare IPA II (2014–2020). Gjatë asaj periudhe janë financuar projekte të shumta në fushën e turizmit, mbrojtjes së mjedisit jetësor, inkluzionit social dhe inovacionit. Cikli i ri 2021–2027 përfaqëson vazhdimësinë dhe zgjerimin e bashkëpunimit, me një buxhet më të madh dhe një fokus më të gjerë tematik. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë personat juridikë të regjistruar në zonën e programit, përfshirë vetëqeverisjet lokale, institucionet publike, universitetet, qendrat kërkimore, agjencitë zhvillimore dhe organizatat joqeveritare.

<sup>6</sup> 1st Call for Proposals – IPA Cross-Border Cooperation Programme Montenegro-Kosovo 2021-2027 cf9d92\_en

<sup>7</sup> Cross-border Programme SRB-MNE Cross-border Programme SRB-MNE



OJQ-të nga Mali i Zi janë partnerë plotësisht të pranueshëm dhe mund të jenë bartës të projekteve (lead applicants) ose partnerë, me kusht që projekti të përfshijë partnerë nga Kroacia dhe Bosnjë-Hercegovina. Buxheti i përgjithshëm i programit për periudhën 2021–2027 kap vlerën prej rreth 67 milionë eurosh. Programi është i orientuar drejt forcimit të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe territorial të zonave kufitare midis tre vendeve, përmes projekteve të përbashkëta që kontribuojnë në inovacion, konkurrueshmëri, mbrojtjen e mjedisit jetësor, inkluzionin social dhe turizmin e qëndrueshëm. Qëllimi i përgjithshëm i programit është të lidhë komunitetet lokale dhe institucionet nga Kroacia, Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi, me qëllim që të zgjidhen bashkërisht sfidat në zonat kufitare dhe të nxitet integrimi në rrjedhat evropiane. Programi është i strukturuar përmes katër prioritetëve kryesore: investimet e mençura në kërkim, inovacion dhe ndërmarrësi konkurruese; zhvillimi i gjelbër dhe mbrojtja e mjedisit jetësor; inkluzioni social dhe shëndeti; si dhe turizmi dhe kultura.

### **Interreg Europe**

Programi është i orientuar drejt shkëmbimit të përvojave dhe politikave midis rajoneve evropiane. Pjesëmarrja e OJQ-ve në këtë program ka një vlerë të shumanshme: nga njëra anë, u mundëson atyre të përfshihen në krijimin dhe vlerësimin e politikave publike, ndërsa nga ana tjetër kontribuon në profesionalizimin e tyre përmes shkëmbimit të njohurive dhe praktikave me organizata nga vendet e tjera evropiane. Pjesëmarrja e OJQ-ve në programin Interreg Europe, i cili synon shkëmbimin e përvojave dhe politikave midis rajoneve evropiane, ka një vlerë të dyfishtë: nga njëra anë, u mundëson atyre të përfshihen në krijimin dhe vlerësimin e politikave publike, ndërsa nga ana tjetër kontribuon në profesionalizimin e tyre përmes shkëmbimit të njohurive dhe praktikave me organizata nga vendet e tjera evropiane.

### **Interreg Programi Transnacional i Danubit (Interreg Danube Transnational Programme - DTP)**

Programi përfaqëson një kornizë të rëndësishme bashkëpunimi që përfshin vendet e rajonit të Danubit, duke përfshirë edhe Malin e Zi. Ky program financoj projektet në fushat e inovacionit, transportit, mbrojtjes së mjedisit jetësor, efikasitetit energjetik dhe bashkëpunimit institucional. OJQ-të nga Mali i Zi përmes DTP-së kanë mundësinë të përfshihen në projekte transnacionale që lidhin vendet e Danubit me qëllim të zgjidhjes së përbashkët të sfidave zhvillimore. Pjesëmarrja në këtë program është veçanërisht e rëndësishme sepse u mundëson organizatave malazeze të lidhen me një rrjet të gjerë partnerësh nga Evropa Qendrore dhe Lindore, duke hapur kështu hapësirë për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave në një nivel më të gjerë rajonal.

### **Interreg Programi Transnacional Adriatiko-Jonik**

Programi përfshin vendet e rajonit Adriatiko-Jonik. Në program marrin pjesë 10 shtete: Italia, Sllovenia, Kroacia, Greqia, Mali i Zi, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe San Marino. Programi lidh vendet anëtare të BE-së dhe vendet përfituese të fondeve IPA.

Fushat tematike të programit Interreg ADRIION përfshijnë:

- Inovacionin dhe zhvillimin e mençur përmes forcimit të sistemeve rajonale të inovacionit;
- Mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore duke promovuar turizmin e qëndrueshëm;
- Qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe ruajtjen e mjedisit jetësor përmes një menaxhimi më të mirë të burimeve.

Programi fokusohet njëkohësisht në zhvillimin e transportit të qëndrueshëm dhe të mobilitetit në rajonin Adriatiko-Jonik, ndërsa vëmendje të veçantë i kushton forcimit të kapaciteteve institucionale dhe qeverisjes përmes bashkëpunimit transnacional. Në këtë mënyrë, ADRIION lidh vendet e rajonit në projekte të përbashkëta që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm, forcimin e konkurrueshmërisë dhe integrimin e tyre në rrjedhat evropiane.



Aplikantë mund të jenë institucionet publike, vetëqeverisjet lokale, universitetet, institutet kërkimore, agjencitë zhvillimore dhe organizatat joqeveritare, me kusht që selia e tyre të jetë në zonën e programit. Organizatat joqeveritare nga Mali i Zi janë plotësisht të pranueshme si bartëse të projekteve, por edhe si partnere në projekte. Kushti kyç është që projekti duhet të përfshijë bashkëpunimin transnacional, që do të thotë se duhet të ketë partnerë nga të paktën tri vende pjesëmarrëse në programin ADRION. Buxheti i përgjithshëm i programit ADRION për këtë periudhë (2021–2027) kap vlerën prej 136 milionë eurosh, i financuar nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF) dhe mjetet IPA III. Mjetet ndahen përmes thirrjeve për dorëzimin e propozim-projekteve, ndërsa fokusi është në projektet transnacionale që përfshijnë partnerë nga të paktën tri vende pjesëmarrëse.

### Interreg Programi Transnacional Euro-Mesdhetar

Mali i Zi është përfshirë në programin Interreg Euro-MED që nga fillimi i ciklit të ri financiar 2021–2027, si vend kandidat. Përmes kësaj, institucionet dhe organizatat e tij joqeveritare kanë fituar mundësinë të marrin pjesë në projekte transnacionale së bashku me partnerët nga vendet e Mesdheut.

Fushat e mbështetjes: Programi është i orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm të hapësirës mesdhetare, me një fokus të veçantë në mbrojtjen e mjedisit jetësor, menaxhimin e burimeve ujore, ekonominë qarkulluese, parandalimin e mbetjeve, ndryshimet klimatike dhe inovacionet në zonat rurale dhe bregdetare. Përveç temave ekologjike, Euro-MED mbështet edhe projekte që kanë të bëjnë me transformimin digjital, inkluzionin social dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

Organizatat joqeveritare nga Mali i Zi mund të përfshihen në projekte që merren me veprimet për klimën, mbrojtjen e detit dhe zonave bregdetare, inovacionet në komunitetet lokale dhe zhvillimin e modeleve të qëndrueshme të turizmit. Pjesëmarrja në programin Euro-MED hap hapësirë për bashkëpunim me një rrjet të gjerë partnerësh nga vendet e Mesdheut, gjë që mundëson shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe praktikave të mira. Është veçanërisht e rëndësishme që OJQ-të nga Mali i Zi mund të jenë partnere të barabarta në konsorciume, me mundësinë për të zbatuar aktivitete që kanë një ndikim direkt në komunitetet lokale.

Korniza financiare: Buxheti i programit Interreg Euro-MED për periudhën 2021–2027 kap vlerën prej pothuajse 300 milionë eurosh, ndërsa grantet individuale për partnerët lëvizin në një rritje prej 100.000 deri në 300.000 euro, varësisht nga vëllimi dhe fokusi tematik i projektit. OJQ-të malazeze janë përfshirë tashmë në konsorciumet e para të projekteve, veçanërisht në fushat e mbrojtjes së burimeve natyrore dhe ndryshimeve klimatike.

### Erasmus +

Programi Erasmus+ përfaqëson një nga instrumentet më të rëndësishme të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit. Ky program nuk funksionon ekskluzivisht si një kornizë financiare, por si një instrument strategjik për nxitjen e mobilitetit, shkëmbimin e njohurive dhe zhvillimin e identitetit evropian ndërmjet të rinjve dhe organizatave të shoqërisë civile. Erasmus+ dallon dy kategori pjesëmarrësish: vendet e programit (shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e treta të asociuara) dhe vendet partnere (vendet e treta që nuk janë të asociuara me programin). Mali i Zi në programin Erasmus+ ka statusin e vendit partner, që do të thotë se institucionet dhe organizatat e tij joqeveritare mund të marrin pjesë në aktivitete të caktuara, por nuk gëzojnë të njëjtin vëllim të drejtash dhe mundësish si organizatat nga vendet e programit. Për universitetet malazeze, institucionet publike dhe OJQ-të është e mundur të përfshihen në projekte të mobilitetit të studentëve dhe stafit, si dhe në bashkëpunim në fushën e rinisë dhe sportit. Megjithatë, për dallim nga vendet e programit, Mali i Zi nuk ka qasje në të gjitha veprimet e programit Erasmus+ dhe as nuk mundet në të gjitha rastet të dorëzojë aplikime për projekte direkt në Komisionin Evropian. Në vend të kësaj, organizatat nga Mali i Zi më së shpeshti u bashkohen konsorciumeve të udhëhequra nga institucionet e BE-së ose të vendeve të programit

Për organizatat joqeveritare, statusi i vendit partner do të thotë se ato mund të përfshihen në projektet Erasmus+ në disa fusha kryesore:

- Mobiliteti i të rinjve dhe punonjësve rinorë: OJQ-të mund të jenë partnere në projekte të shkëmbimit rinor, trajnimit të punonjësve rinorë dhe iniciativave vullnetare. Kjo hap hapësirë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe shkëmbim përvojash, por më së shpeshti përmes partneriteteve, dhe jo si aplikantë kryesorë.
- Bashkëpunimi në fushën e sportit: OJQ-të që veprojnë në sektorin e sportit mund të marrin pjesë në projekte që promovojnë inkluzionin, stilin e shëndetshëm të jetesës dhe kohezionin social.
- Arsimi i lartë dhe bashkëpunimi me universitetet: OJQ-të që punojnë në fushën e arsimit mund të përfshihen në projekte bashkëpunimi ndërmjet universiteteve dhe sektorit civil, veçanërisht në projekte që merren me zhvillimin e kompetencave dhe metodave inovative në arsim.

Statusi i vendit partner në programin Erasmus+ për Malin e Zi do të thotë se organizatat joqeveritare kanë mundësi reale për t'u përfshirë në projekte të mobilitetit, rinisë dhe sportit, por se roli i tyre mbetet i kufizuar në krahasim me organizatat nga vendet e programit. Ato më së shpeshti shfaqen si partnere në konsorciume ndërkombëtare, ndërsa mundësia e tyre për të qenë aplikantë kryesorë në shumicën e veprimeve është e kufizuar. Me gjithë këtë, Erasmus+ mbetet një instrument i rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e sektorit civil malazez, forcimin e kapaciteteve të OJQ-ve dhe lidhjen me partnerët evropianë.

## Horizon Europe

Mali i Zi është i asociuar me programin Horizon Europe që nga viti 2021, me çka institucionet dhe organizatat e tij joqeveritare kanë fituar mundësinë të marrin pjesë në programin më të madh të kërkimit dhe inovacionit të Bashkimit Evropian. Horizon Europe është vazhdimësi e programit Horizon 2020 dhe përfaqëson një instrument kyç të BE-së për financimin e kërkimeve shkencore, inovacionit dhe veprimeve për klimën. Statusi i vendit të asociuar do të thotë se personat juridikë nga Mali i Zi kanë të drejtë të përfshihen si të barabartë në konsorciumet e projekteve së bashku me partnerët nga shtetet anëtare të BE-së.

